

PLANI VENDOR I RINISË ELBASAN
2023 - 2026

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	3
METODOLOGJIA	7
SITUATA E TË RINJVE NË ELBASAN	8
VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË	12
Vizioni	12
Fushat e ndërhyrjes	12
Objektivat specifikë	12
PLANI I VEPRIMIT	13

HYRJE

I ndodhur në një pozicion të favorshëm gjeografik, i pasur me burime natyrore, së bashku me trashëgiminë e tij historike dhe social-kulturore, Elbasani është një nga rajonet më të rëndësishme në Shqipëri. Elbasani ka një popullsi prej 266,245 banorësh¹, duke u renditur kështu si rajoni i katërt më i madh në vend me 9.4% të popullsisë shqiptare. Ashtu si çdo rajon në Shqipëri, popullsia ka ardhur në rënie gjatë 20 viteve të fundit, në këtë rast me një rënie prej rreth 26%, kryesisht për shkak të migrimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe dinamikave të tjera demografike².

Bashkia Elbasan ka zbatuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë 2020-2023 që ka synuar hartimin e një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxiste zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Vizioni i planit ishte krijimi i kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre.

Këshilli Rinor Elbasan është krijuar që në vitin 2019 si një strukturë rinore e pavarur që këshillon lidhur me çështjet rinore institucionet e qeverisjes vendore. Këshilli rinore ka bashkëpunuar me qeverisjen vendore për të përfshirë të rinjtë në procesin e vendimmarrjes, zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për të rinjtë. Në shtator të vitit 2022 Këshilli Bashkiak Elbasan ka miratuar kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 “Për rininë” dhe ligji 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Qëllimi i Këshilli Vendor Rinor është të promovojë dialogun midis brezave, të përmirësojë angazhimin e të rinjve dhe t’i fuqizojë ata për t’u përfshirë aktivisht në proceset e vendimmarrjes politike vendore ku kërkohet zëri i të rinjve.

Këshilli Vendor Rinor do t’i ndihmojnë të rinjtë të ndërtojnë një të ardhme më të mirë, të avancojnë qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre përmes promovimit aktiv të procesit demokratik dhe qeverisjes së mirë. Pjesëmarrja e organizatave rinore dhe të rinjve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet Këshillit Vendor Rinor do të bëjë të mundur adresimin e çështjeve të rëndësishme vendore që shqetësojnë të rinjtë në një komunitet, për të përmirësuar jetën e të rinjve dhe për të vënë para përgjegjësisë qeverisjen vendore.

Këshilli Rinor në zbatim të planit vjetor ka realizuar aktivitete të ndryshme për gjatë vitit me të rinjë dhe fëmijët e qytetit dhe fshatrave. Disa nga aktivitetet e zhvilluara kanë qenë: “Talenti je ti”, “Sëbashku për mjedisin”, “Të rinjtë dhe politika, e ardhmja na perket ne”, “Vullnetarizmi,

¹ INSTAT, Popullsia Shqiptare – 1 janar 2021, 2021.

² IDRA, 2021. Analiza e tregut rajonal të punës dhe zhvillimit ekonomik në Elbasan.

më shumë se një mision”, “Bëhu vendimarrës”, “Përgjithmonë bamirës”, “Unë do t’ia dal”, “Për Qytetin tim”, “Të rinjtë dhe dita e verës”, “Pikturo parkun, krijo një lojë”, “Funny Money”, “Buzëqesh me ne”, “Arti përmes vështrimit të të rinjve”, “Mbrëmja e fëmijëve”, “Pastërtia e mjedisit fillon me mua”, “Workshop teatral”, “Realizo një ëndërr”, “Fol me babagjyshin”. Aktivitetet kanë patur si qëllim rritjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjen vendor; organizimin e konkurseve në pikturë, poezi dhe kampionateve sportive ndërmjet shkollave; angazhimin e të rinjve në nismat për mbrojtjen e mjedisit dhe mbështetja e tyre në aktivitetet e ndërmara nga ata në mbrojtjen mjedisore si dhe fushata ndërgjegjësimi me fokus mjedisin; realizimin e sesioneve informuese mbi qeverisjen me pjesëmarrje, prezantimin e të drejtave të komunitetit, ligjit të informimit, ligjit për funksionimin e pushtetit vendor si dhe njohja me funksionet dhe detyrat e Këshillit Bashkiak; aktivitete për nxitjen e vullnetarizimit tek të rinjtë dhe krijimin e modeleve të bashkëpunimit mes të rinjve vullnetarë dhe strukturave shtetërore, në ndihmë të komunitetit në raste emergjencash natyrore, dhe jo vetëm; fushata advokuese dhe lobuese të të rinjve për ti nxitur të marrin pjesë në vendimarrjen lokale por edhe për të qenë ata nismëtarë vendimesh të ndryshme në dobi të të rinjve; realizimin e fushatave të bamirësisë me qëllim grumbullimin e fondeve sociale nga të rinjtë me mbështjen e institucioneve lokale, OJF dhe bizneset; organizimin e “Start Up”-eve dhe sigurimin e Granteve për t’ua vënë në dispozicion të rinjve që kanë një ide biznesi; zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të ditës së verës; zbulimin e parkut me piktura duke krijuar një larmishmëri ngjyrash por njëkohësisht duke i kthyer këto të fundit në lojëra zbavitëse për fëmijët; shfaqje rinore teatrale; aktivitete të ndryshme përgjatë mujeve të verës që fëmijët janë pushim për argëtimin e fëmijëve nëpërmjet lojërave, muzikës, artit, sportit, kinema verore; ekspozitë me fotografi të të rinjve me qëllim që të ofrojë mundësin për të rinjtë për të shprehur zërat e tyre mbi temat që kanë rëndësi për ta; lexime të përrallave dhe shfaqje me animatorë të cilët kanë zhvilluar lojëra të ndryshme për fëmijët; zhvillimi i fushatave të pastrimit, pyllëzimit apo riciklimit me qëllim rritjen e sensibilitetit të të rinjve dhe komunitetit mbi mbrojtjen e mjedisit; Workshop me të rinjtë që të kuptojnë më nga afër se si funksionon vënja në skenë e një pjese teatrale; mbështetja e të rinjve të angazhuar në fushën e interpretimit dhe montazhit grafik, dhe zhvillimi i mundësive krijuese të të rinjve në fushën e filmit; zhvillimi i aktiviteteve me rastin e festave të fundvitit në sheshin qendror të qytetit.

Plani Vendor i Rinisë Elbasan është një mjet dhe burim që do të udhëheqë bashkinë në punën e saj me të rinjtë, komunitetin, ofruesit e shërbimeve rinore dhe palët e tjera të interesuara për të përmbushur nevojat e të rinjve të Elbasanit dhe për të ndërtuar një qytet miqësor ndaj të rinjve.

Qëllimi i Planit Lokal të Veprimit për Rininë Elbasan është:

- Të identifikojë nevojat e të rinjve të Elbasanit dhe të zhvilloj aktivitete dhe ndërhyrje që adresojnë këto nevoja;
- Të ndërtoj mbi iniciativat ekzistuese dhe të identifikoj mundësitë për të punuar në bashkëpunim me aktorë dhe institucione të ndryshme në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar
- Të advokoj për fushat që konsiderohen shqetësim për të rinjtë.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese; në fushën e mbrojtjes së mjedisit; në fushën e zhvillimit ekonomik vendor; në fushën e sigurisë publike, etj.

Ligji për Rininë³ përcakton aktivitetet, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve si në Shqipëri dhe diasporë dhe rrit pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Ligji u miratua për të mbrojtur të drejtat e të rinjve dhe për të krijuar kushte për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre. Ligji parashtron krijimin e një baze ligjore për dy struktura konsultative rinore: Këshilli Kombëtar i Rinisë (KKR) dhe Këshilli Vendor i Rinisë (KVR) të cilat duhen fuqizuar dhe ngritur në ato bashki ku nuk ekzistojnë. Ligji parashikon sigurimin e burimeve të financimit për politikën, programet dhe aktivitetet rinore, duke theksuar kontributin e buxheteve vendore në këtë drejtim, krahas buxhetit të shtetit. Në të njëjtën kohë, ai parashikon burime të tjera të ligjshme financimi, si të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e organizatave rinore, donacionet, sponsorizimet, programet evropiane etj.

Institucioni përgjegjës për rininë është Agjencia Kombëtare për Rininë (AKR) e krijuar me vendimin nr. 681, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave dhe zëvendëson Shërbimin Kombëtar Rinor (SHKR). Këshilli Kombëtar i Rinisë, një organ këshillimor që funksionon në kuadër të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe është përgjegjës për rininë.

Këshilli Vendor i Rinisë është një organ këshillimor, i cili funksionon në varësi të kryetarit të bashkisë në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme: a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë; b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor; c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë; ç) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë

Ligji për rininë parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikën vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për: a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe

³ Ligji nr. 75/2019, “Për rininë”

prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre; b) krijimin e këshillit vendor të rinisë; c) organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve; ç) organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve; d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre; dh) financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta; e) krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë; ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore; f) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Politika kombëtare e strategjisë së rinisë⁴ dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të rejat dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të marginalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social. Kjo strategji synon të orientojë rininë shqiptare për veprim të mëtejshëm i cili ndikon pozitivisht në të ardhmen e tyre. Politikat që zhvillohen në kuadër të kësaj strategjie kanë këto qëllime:

- Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërat e tyre.
- Rritje e aftësive për punësimin e të rinjve, mbështetur nga shërbimet e këshillimit të karrierës dhe punësimit që janë të orientuara nga të rinjtë, rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të drejtësisë dhe të shanseve të barabarta.
- Mirëqenie aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve
- Novacion dhe edukim cilësor për të mbështetur të rinjtë për të arritur potencialin e tyre të plotë
- Siguri, mbrojtje dhe gjithëpërfshirje e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo vulnerabiliteti.
- Politika ndërsektoriale rinore e koordinuar, e bazuar në fakte, me mekanizma të mirëfinancuar të ofrimit, monitorimit dhe vlerësimit horizontal dhe vertikal.

Në vitin 2018 është ngritur Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) e cila ka për mision zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë të përfshirë në masat kundër ekstremizmit të dhunshëm, me qëllim mbrojtjen e shoqërisë shqiptare.

⁴ Vendim Nr. 692, datë 26.10.2022 Për miratimin e strategjisë kombëtare të rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029

Strategjia Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2022-2025⁵ përcakton vizionin kombëtar për krijimin e një shoqërie pa kërcënime terroriste, me imazhin e një vendi të sigurtë dhe me standarde evropiane të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë periudhës 2022- 2025. Në strategji si një nga fushat prioritare parashikohet pjesëmarrja e të rinjve për parandalimin e ekstremizmit, radikalizmit të dhunshëm dhe përfshirjes në akte terroriste kryesisht të të rinjve.

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) është një mekanizëm që ka si qëllim angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve publikë dhe jo-publik në nivel lokal e më tej, kjo në funksion të parandalimit dhe adresimit të sfidave dhe kërcënimeve të lidhura me sigurinë publike. KVSP ka si qëllim identifikimin e pikave të nxehta në lidhje me situatat kriminale, aksidentet në qarkullimin rrugor, sjelljet anti-shoqërore dhe kundërvajtjet si dhe marrjen e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve. Aktualisht, KVSP-ja përbëhet nga anëtarë përfaqësues të: Bashkisë; Prokurorisë; Policisë; Institucione publike në nivel lokal; Anëtarë të Këshillit Bashkiak; përfaqësues të shoqërisë civile; Dhomës së tregëtisë; Medias; Bashkësive fetare; Komuniteteve etnike etj. Gjithashtu, është ngritur Cikli Spiral i Bashkëpunimit të Trekëndëshit Bashki-Prokurori-Polici i cili mundëson përcjelljen dhe adresimin e problematikave të ngritura në KVSP në tryeza të tjera diskutimesh dhe marrjen e masave konkrete. Ngritja e këtij mekanizmi është shoqëruar me hartimin e planit të veprimit si edhe rregulloren e funksionimit të KVSP-së të cilat mundësojnë gjithëpërfshirjen e komuniteteve vendore dhe adresimin e sfidave të lidhura me sigurinë". Parashikohet që në KVSP të këtë edhe një përfaqësi nga të rinjtë të cilët në bashkëpunimin me aktorë të tjerë do të planifikojnë aktivitete për adresimin e problematikave të lidhura me sigurinë.

METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e Planit Vendor të Rinisë 2023-2026 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

Faza e Parë:

Mbledhja e dokumentave, raporteve, të dhënave të publikuara për situatën e të rinjve në nivel vendor.

Përfshirja e të rinjve për identifikimin e nevojave, shqetësimeve dhe problematikave të tyre. Përcaktimi i fushave prioritare të planit të veprimit. Identifikimi i prioritetëve përmes takimeve dhe konsultimeve me të rinjtë e përfshirë në këtë proces, për të identifikuar hapat konkretë të

⁵ Vendim, Nr. 81, date 14.02.2023. Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit dhe planet e veprimit 2023-2025.

planit të veprimit. Përmes analizës SWOT, të rinjtë kishin mundësinë që të evidentojnë pikat e forta dhe ato të dobëta, mundësitë dhe mangësitë dhe të përcaktonin prioritetet kryesore.

Zhvillimi i takimeve dhe intervistave individuale me stafin e bashkisë dhe të rinjtë në Elbasan. Konsultimi me të rinjve nga zonat urbane dhe rurale për një pjesëmarrje të të gjitha grupeve.

Faza e dytë:

Drafti i përgatitur për konsultim përmbante seksionet dhe të dhënat kryesore, vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat e veprimit e parashikuara për arritjen e objektivave specifike. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

Faza e tretë:

Konsultim me përfaqësuesit e Bashkisë Elbasan dhe Terre des homme i draftit të Planit të Veprimit.

Reflektimi i komenteve dhe sygjërimeve.

SITUATA E TË RINJVE NË ELBASAN

Në vitin 2021, të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, të cilët nuk janë të punësuar, nuk janë duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional, përbëjnë 26,1 % të të rinjve gjithsej. Në këtë grup, 37,3 % e të rinjve janë të papunë. Pjesa tjetër janë jashtë tregut të punës për arsye se janë të dekurajuar (15,4 %), duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (17,5 %), ose për arsye të tjera (29,8 %). Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2021, qarqet me shkallë punësimi më të lartë janë: Gjirokastra (65,6 %) dhe Elbasani (62,2 %) ⁶.

Bashkia Elbasan, është qendra me e rëndësishme demografike, administrative dhe ekonomike e qarkut me të njëjtin emër. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Elbasan, përfshin nën juridiksionin e saj administrativ qytetin e Elbasanit dhe 13 njësitë administrative, Labinot mal, Funarë, Labinot fushë, Bradashesh, Gracen, Shushicë, Papër, Shirgjan, Gjergjan, Gjinar, Tregan dhe Zavalin.

Në qarkun e Elbasanit të rinjtë përbëjnë 47% të gjithë popullësisë duke e renditur si qarkun e parë me përqëndrimin më të lartë të të rinjve në vend. Ndërkohë ky përqëndrim në njësitë administrative rurale shkon në 33% ⁷. Sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia Elbasan në vitin 2018 numërohen gjithsej 43,289 të rinjë ose 20% e popullsisë ⁸. Punësimi rinor mbetet një

⁶ INSTAT, 2021. Tregu i Punës 2021.

⁷ KRK, 2021. Master Plani i Punësimit në Bashkinë Elbasan

⁸ Te dhena, Bashkia Elbasan, 2018.

problem serioz i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga organizatat rinore në bashkëpunim me autoritete vendore dhe komunitetin e biznesit.

Sipas raportit të IDRA aktiviteti sipërmarrës është 'i fjetur' dhe më së shumti i fokusuar në aktivitete mikro në fusha të tilla si turizmi, bujqësia dhe artizanati. Palët e interesuara pohojnë se migrimi i brendshëm i 40 profesionistëve të kualifikuar drejt Tiranës, ose aftësia e tyre, për shkak të distancës së shkurtër, për të punuar në Tiranë, po ndikon në mjedisin sipërmarrës në Elbasan – duke e lënë atë të amullt dhe të pazhvilluar. Disa politika për nxitjen e sipërmarrjes përfshijnë: (i) qasjen tek financimet; (ii) inkurajimin e rrjeteve të biznesit ndërmjet sipërmarrësve aspirantë dhe mentorëve të biznesit, si p.sh. nëpërmjet ekosistemeve të startup-eve; (iii) sigurimin e edukimit për sipërmarrjen të bazuar në gjenerata, duke përfshirë skemat e zhvillimit të sipërmarrjes së të rinjve që përshtaten me nevojat e veçanta të brezit mijëvjeçar.⁹

Përsa i përket punësimit, Bashkia Elbasan ka hartuar një sërë politikash ekonomike për tu ardhur në ndihmë të rinjve dhe grupeve të marginalizuara. Aktualisht janë zhvilluar një sërë politikash dhe programesh si¹⁰:

- Certifikimi i strukturës rinore pranë Bashkisë Elbasan “Këshilli Rinor Elbasan” si një strukturë që sjell në bashki zërin dhe nevojat e të rinjve.
- Projekte bashkëpunimi me rajone të Maqedonisë së Veriut në lidhje me orientimin dhe punësimin e të rinjve, veçoritë dhe të përbashkëtat që ka ky proces për të rinjtë e rajonit.
- Zbatimi i projektit të përvitshëm “Bursa për gjimnazistët”, përfitues të të cilit janë gjithë nxënësit gjimnazistë, që kanë përfunduar klasën e XI dhe të XII me të gjitha notat dhjeta por dhe ata që janë në kushte nevoje.
- Bashkëpunimi disa vjeçar me Shoqatën “Tjetër Vision” dhe Fondacionin Sanzeno të Italisë në zbatim të Projektit Orientimi dhe punësimi i të rinjve, Elbasan. Hapja e Portalit Rinia.El në web-in e Bashkisë Elbasan është një mundësi konkrete për të rinjtë dhe sidomos për grupet e marginalizuar.
- Maratona Rinore, projekt i përvitshëm i Bashkisë me shkollat e mesme që synon organizimin e një konkursi, ku të rinjtë pjesëmarrës, kanë mundësi të shpalosin talentet e tyre.
- Angazhimi vullnetar i të rinjve në aktivitete të tjera të organizuara nga Bashkia gjatë vitit, si Dita e Verës, Vullnetarizmi etj, si edhe aktivitete të tjera kulturore, argëtuese gjatë kohës së tyre të lirë, të organizuara nga Qendra Rinore Elbasan.
- Programi Kombëtar i Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore, e cila ofron praktika profesionale me stimuj financiarë, të implementuara nga Ministria e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Elbasan dhe zbatuar nga Bashkia Elbasan. (Studentë të cilët kanë përfunduar arsimin 2 vitet e fundit,

⁹IDRA, 2021. Analiza e tregut rajonal të punës dhe zhvillimit ekonomik në Elbasan.

¹⁰KRK, 2021. Master Plani i Punësimit në Bashkinë Elbasan

janë angazhuar në drejtori të ndryshme në Bashki sipas profilit të studimit, për te kryer praktika profesionale për një periudhë kohore prej 3- 6 muajsh).

- Ofrimi i praktikave mësimore për studentët, që vazhdojnë studimet në Universitetin “A. Xhuvani”, Elbasan dhe angazhimi i tyre vullnetar në aktivitete të zhvilluara nga Bashkia Elbasan.
- Aktivitete sportive dhe argëtuese të organizuara nga Bashkia enkas për Kampionatet e shkollave të mesme në futboll dhe lojra me dorë, atletikë etj
- Bashkepunimi i vazhdueshëm me Universitetin A. Xhuvani për orientimin në karrierë të të rinjve maturantë të shkollave të mesme, koordinimi i projekteve për një përjasje sa më reale të nevojave të të rinjve të Bashkisë Elbasan me tregun lokal të punësimit dhe të biznesit.

Struktura e qeverisë vendore në Elbasan paraqet një ndarje të përgjithshme të përgjegjësiave për zbatimin e veprimtarive, nismave dhe projekteve vendore, të zbatuara nga një sërë drejtorish, si: Drejtoria e Politikave të Trashëgimisë Kulturore, Turizmit, Artit dhe Sportit. Kjo drejtori siguron rritjen e jetës artistike kulturore për të gjitha grupmoshat me qëllim shndërrimin e qytetit të Elbasanit si një qendër kulturore me standarde europiane; krijimin e mundësive çdo artisti të ri të rritet profesionalisht dhe të vlerësojë kontributin e çmuar të artistëve të njohur brenda dhe jashtë vendit. Harton politika dhe plane veprimi duke synuar nxitjen dhe intensifikimin e jetës sportive, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së ambienteve sportive me parametra bashkëkohorë¹¹.

Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit ka mision zbatimin e politikave në fushën e arsimit parashkollor dhe realizimin e qëllimeve që rrjedhin prej tyre duke mundësuar sigurimin e një sistemi arsimor cilësor që mundëson zhvillimin e plotë dhe të gjithanshëm të individit, shanse të barabarta si dhe formimin e çdo individit. Kjo drejtori mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor të institucioneve të arsimit parashkollor. Në zonën e Elbasanit, veprojnë një numër i madh aktorësh dhe organizatash të shoqërisë civile. Ka rreth 22 OSHC aktive. Shumica e këtyre OSHC-ve përqendrohen në një sërë problematikash dhe tematikash lidhur me të rinjtë, dhe promovojnë veprimtaritë e tyre, me fokus të veçantë tek pjesëmarrja e të rinjve, të drejtat e tyre, rritja e aftësive për tregun e punës, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm nga të rinjtë¹².

Bashkia Elbasan ka ngritur struktura të ndryshme që kanë në fokus pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjve në vendimmarrje si Qendra Rinore, Këshilli Rinor Vendor Elbasan, dhe OJF të ndryshme që zhvillojnë aktivitete për fuqizimin e të rinjve dhe adresimin e nevojave. Ato ofrojnë mundësi informim dhe akses të barabartë për t'a marrë këtë informacion për të gjithë.

¹¹ Te dhena nga faqja e Bashkisë Elbasan. <https://elbasani.gov.al/drejtore/>

¹² Te dhena nga faqja e Bashkisë Elbasan. <https://elbasani.gov.al/drejtore/>

Mjedisi mbetet prioritet për jetën dhe shëndetin e cdo qytetari elbasanas për shkak të ndotjeve të trashëguara dhe industrisë së rëndë ekzistuese. Elbasani ka rritur investimet në fushën e sportit me qëllim promovimin e talenteve në sporte individuale dhe kolektive. Ka akoma nevojë ngjitjen e terreneve sportive brenda dhe jashtë shkollave, shtimi hapësirave të gjelbëruara dhe promovimi i talenteve në sport dhe art. Organizim i më shumë shfaqjeve / ekspozitave / olimpiadave / maratonash, promovimi i turizmit të zonës/qarkut, ngritja e qendrave/klubeve rinore të tjera duke qenë një qytet studentor, edukim mjedisor dhe konkurse artistike janë disa nevoja specifike në qytetin e Elbasanit.

Vullnetarizmi vlerësohet një ndër praktikatat më efikase për ndërtimin e komuniteteve më të qëndrueshme, kohezive dhe sjell benefite të panumërta në dobi të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor. Studimi kombëtar I vitit 2021 raporton se 90% e të pyeturve, shprehen se nuk kanë informacion se ku dhe si mund të japin kontributin e tyre vullnetar. Më pak të orientuar dhe informuar rreth praktikave vullnetare janë të rinjtë e grupmoshës 18-19 vjeç. Ko tregon nevojën emergjente për të sensibilizuar dhe rritur nivelin e informacionit të rinjtë në lidhje me orientimin për vullnetarizmin. Institucionet më të përmendura nga pjesëmarrësit presin që të informohen janë: Organizata të shoqërisë civile, bashkinë/njësinë administrative dhe qendrat rinore. Pjesa dërmuese e të pyeturve dakortësohen me idenë që vullnetarizmi në Shqipëri duhet të nxitet, fuqizohet dhe promovohet (93%). Përvec OJF, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm, pasi perceptohen si ofruesit e shërbimeve në nivel vendor dhe pushteti më afër qytetarëve.¹³

Të dhënat e studimit të zhvilluar nga IDM në vitin 2018 raportojnë që kur ndërthuren me informalitetin, papunësinë, me shërbimet publike të cilësisë së dobët dhe zhgënjimin e të rinjve, këto probleme të shoqërisë përbëjnë disa nga tiparet më të zakonshme të zonave në Shqipëri ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të gjejnë një mjedis mundësues. Nxitësit social-ekonomikë në veçanti janë kërcënim për grupe të marginalizuara, siç janë të papunët ose të rinjtë, të cilët përballen me përjashtim të vërtetë apo të perceptuar nga mundësitë e zhvillimit ekonomik. Ashtu si në shumë vende të tjera, grupet radikale apo ekstremiste që premtojnë përfitime materiale për ndjekësit e tyre kanë më shumë gjasa të rekrutojnë të rinj që udhëhiqen nga lakmia. Ekzistenca e individëve apo grupeve që nxisin ekstremizmin fetar konfirmohet nga përqindje më të mëdha se mesatarja kombëtare, veçanërisht në bashkitë Krujë, Elbasan, Shijak, Durrës, Bilisht dhe Kamëz.¹⁴ Shqipëria është e njohur për traditën e saj të tolerancës fetare teksa aktet e dhunshme me motive fetare kanë munguar pothuajse plotësisht në vend. Sidoqoftë, bashkëjetesa paqësore e komuniteteve fetare në Shqipëri nuk do të thotë që radikalizmi dhe ekstremizmi fetar mungojnë tërësisht. Nevojiten strategji me përfshirjen e shumë aktorëve për të trajtuar në mënyrë graduale kontekstin e gjerë social, ekonomik dhe

¹³ Leviz Albania, 2021. Vullnetarizmi ne Shqiperi

¹⁴ IDM, 2018. Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve

kulturor që nxit sjellje ekstremiste dhe të dhunshme, veçanërisht tek të rinjtë. Për parandalimin duhet të ndërthuren nismat që vijnë nga komuniteti lokal, qeverisja vendore, institucionet publike, komunitetet fetare, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të shoqërisë.

VIZIONI, FUSHAT E NDËRHRYJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni

Një shoqëri ku të gjithë të rinjtë e Elbasanit mbështeten, angazhohen, vlerësohen dhe të drejtat e tyre zbatohen dhe përmbushen.

Fushat e ndërhyrjes

- Vullnetarizimi dhe pjesëmarrja rinore
- Art, kulture, sport dhe mjedis
- Punësimi dhe sipërmarrja rinore
- Siguria dhe rezilienca e të rinjve kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit (Këshillat Vendor të Sigurisë Publike)
- Shëndet dhe mirëqënie

Objektivat specifikë

- Krijimi i një mjedisi mundësues në nivel vendor ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarise aktive.
- Ndërgjegjësimi dhe përfshirja aktive e të rinjve në vendimarrjen vendore
- Përmirësimi i rezultateve të shëndetit fizik të të rinjve, duke u fokusuar në nevojat e identifikuar, dhe duke përfshirë ushqyerjen dhe jetësen e shëndetshëm, aktivitetin fizikë, përdorimin e sigurt të teknologjisë.
- Përmirësimi i rezultateve të mirëqenies emocionale të të rinjve duke përfshirë: adresimin e stigmës së shëndetit mendor dhe rritjes së të kuptuarit të mirëqenies emocionale dhe fuqizimit të të rinjve për të kërkuar ndihmë.
- Përfshirja e të rinjve në dizenjimin dhe zbatimin e aktiviteteve në fushën e artit, kulturës, sportit dhe mjedisit
- Zhvillimi i aftësive dhe ofrimi imbeshtetjes së nevojshme për të përfunduar me sukses shkollën dhe për të kaluar me besim drejt arsimimit, trajnimit të mëtejshëm ose integritimit në tregun e punës.

- Ofrimi i programeve edukuese që zhvillojnë reziliencën e të rinjve ndaj mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm dhe ngjallin një ndjenjë pozitive të identitetit dhe përkatësisë.
- Përfshirja e të rinjve në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike Elbasan

PLANI I VEPRIMIT

VULLNETARIZMI DHE PJESËMARRJA RINORE				
Objektivi 1: Krijimi i një mjedisi mundësues në nivel vendor ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyc për nxitjen e qytetarise aktive.				
<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Afatet</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financimi</i>
Fushata ndërgjegjësimi me të rinjtë dhe komunitetin mbi rëndësinë e vullnetarizmit	Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit (DPAE) KVR	Çdo 6-mujor	Numri i fushatave Numri I të rinjve pjesëmarrës	
Workshop me të rinjtë për prezantimin e praktikave të mira të vullnetarizimit	DPAE KVR	Çdo 6-mujor	Numri i workshopeve Praktikat e mira të prezantuara	
Aktivitete të të rinjve vullnetarë me të moshuarit, fëmijët dhe grupe të tjera në nevoj	DPAE KVR	Çdo 3-mujor	Numri i aktiviteteve Numri i grupeve përfituese	
Krijimi i grupit të vullnetarëve që ofrojnë mbështetje për komunitetin në rastin e emergjencave	DPAE KVR	Çdo vit	Numri i vullnetarëve të angazhuar Numri i aktiviteteve në të cilat marrin pjesë	
Njohja e punës vullnetare (përgatitja e protokolleve për menyrën e organizimit dhe menaxhimit të vullnetarizmit	Bashkia Elbasan DPAE KVR	Çdo vit	Numri i dokumentatve të hartuara	

në nivel vendor)				
Objektivi 2: Ndërgjegjësimi dhe përfshirja aktive e të rinjve në vendimarrjen vendore				
Trajnime për rritjen e kapaciteteve të të rinjve që janë pjesë e KRV (qeverisja me pjesëmarrje, detyrat e këshillit bashkiak, etj)	DPAE OJF lokale	Çdo vit	Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i pjesëmarrësve	
Trajnime për stafin e Këshillit Bashkiak për të mbështetur pjesëmarrjen kuptimplote të të rinjve përmes ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve për angazhimin e të rinjve në komunitet.	Bashkia OJF lokale	Çdo vit	Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i pjesëmarrësve	
Fushata advokimi në nivel vendor për adresimin e nevojave të të rinjve	DPAE KVR	Çdo 6- mujor	Numri i fushatave të advokimit Çështjet për të cilat është advokuar dhe sa ato janë realizuar	
Kampionati i debatit mes të rinjve	KVR	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve pjesëmarrës nga grupet vulnerable	
Organizimi i forumeve të përbashkëta me të rinjë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar	Bashkia Elbasan DPAE KVR	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës	
SHËNDET DHE MIRËQËNIE				
Objektivi 1: Përmirësimi i rezultateve të shëndetit fizik të të rinjve, duke u fokusuar në nevojat e identifikuar, dhe duke përfshirë ushqyerjen dhe jetësën e shëndetshëm, aktivitetin fizikë, përdorimin e sigurt të teknologjisë.				
Aktivitetet/Masat	Aktorët përgjegjës	Kohëzgjatja	Treguesit	Fondet/Financimi
Aktivitete që edukojnë fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre për çështje të tilla si përdorimi i	DPAE KVR OJF Lokale	Çdo 6- mujor	Numri i aktiviteteve Numri i të	

alkoolit dhe drogave, ushqimi i shëndetshëm dhe siguria ushqimore	Profesionistë të fushës		rinjve pjesëmarrës	
Promovimi i ecjes, ngarjes së bicikletave dhe aktiviteteve sportive për të përmirësuar shëndetin fizik	KVR Klubi shumësportësh	Çdo 6-mujor	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve që promovojnë në mënyrë të qëndrueshme sjellje të shëndetshme	
Aktivitete me shkollat dhe grupet rinore për të promovuar përdorimin e sigurt të teknologjisë për të rinjtë dhe prindërit.	DPAE KVR	Çdo 6-mujor	Numri i aktiviteteve Numri i të rinjve dhe prindërve pjesëmarrës	

Objektivi 2: Përmirësimi i rezultateve të mirëqenies emocionale të të rinjve duke përfshirë: adresimin e stigmës së shëndetit mendor dhe rritjes së të kuptuarit të mirëqenies emocionale dhe fuqizimit të të rinjve për të kërkuar ndihmë.

<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financimi</i>
Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien emocionale	DPAE KVR Profesionistë të fushës	Çdo 6-mujor	Numri i fushatave të advokimit	
Aktivitete për reduktimin e stigmës së shëndetit mendor, duke u fokusuar në rritjen e të kuptuarit të mirëqenies emocionale nga të rinjtë.	DPAE KVR Profesionistë të fushës Shkolla	Çdo 6-mujor	Numri i aktiviteteve	

ART, KULTURE, SPORT DHE MJEDIS

Objektivi 1: Përfshirja e të rinjve në dizenjimin dhe zbatimin e aktiviteteve në fushën e artit, kulturës, sportit dhe mjedisit

<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/</i>
---------------------------------	-----------------------	---------------------------	-------------------------	-----------------------

	<i>përgjegjës</i>	<i>ja</i>		<i>Financimi</i>
Elbasan Art Festë (zbulimi i talenteve dhe më pas zhvillimi i konkurseve në fushat e muzikës, kërcimit, pikturës, skulpturës)	DPAE KVR Shkolla Qendra Kulturore e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve të talentuar	
Elbasan Got Talent	DPAE KVR Shkolla Qendra Kulturore e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve të talentuar	
Ngritja e ansamblit të të rinjve që luajnë muzikë popullore	KVR Qendra Kulturore e Fëmijëve Shkolla e muzikës Onufri	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve të talentuar	
Shfaqje teatrale	KVR Qendra Kulturore e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve të talentuar	
Aktivitete të të rinjve për fëmijët gjatë muajve të verës	KVR Qendra Kulturore e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës	
Kampionate futbollit, basketbolli, volejboli mes të rinjve të shkollave	DPAE KVR Klubi shumësportësh	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve pjesëmarrës nga grupet vulnerable	
Maratonë vrapi ku marrin pjesë të gjitha moshat	DPAE KVR Klubi shumësportësh	Çdo vit	Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës Numri i të	

			rriturve pjesëmarrës	
Aktivite të ndryshme (koncert, pastrim i qytetit, ngritja e balonave, piknik, aktivitete sportive, kinema verore, karaoke, shfaqje teatrale, etj me të rinjtë në zonat rurale (Festa e Labinotit, Festa e Shijomit, Festa e Belshit, Gjinarit, Godoleshit, Funarit etj)	DPAE KVR Klubi shumësportësh Qendra Kulturore e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i aktiviteteve të zhvilluara Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës Numri i të rinjve pjesëmarrës nga grupet vulnerable	
Aktivite për pastrimin e zonave të ndryshme të qytetit në bashkëpunim me komunitetin	DPAE KVR OJF lokale	Çdo 6-mujor	Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës Numri i zonave të pastruara	
Mbjellja e pemëve	DPAE KVR OJF lokale	Çdo vit	Numri i pemëve të mbjelluara	
Aktivite për ditë të caktuara (14 mars, dita e tokës, 1 qershori, festat e 28-29 nëntorit, etj)	DPAE KVR Klubi shumësportësh Qendra Kulturore e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i aktiviteteve të zhvilluara Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës	
Ndarje eksperiencash midis qyteteve të ndryshme (promovimi i të rinjve dhe turizimit të qytetit)	DPAE KVR	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës	
PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE				
Objektivi 1: Zhvillimi i aftësive dhe ofrimi imbeshtetjes së nevojshme për të përfunduar me sukses shkollën dhe për të kaluar me besim drejt arsimimit, trajnimit të mëtejshëm ose integritimit në tregun e punës.				
<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financimi</i>

Seminare informuese me të rinjtë “Jeta pas shkolle”	DPAE KVR Profesionistë të fushës	Çdo vit	Numri i seminareve Numri i të rinjve pjesëmarrës	
Identifikimi i të rinjve që braktisin shkollën herët dhe ofrimi i mundësive që të ndjekin kurse profesionale	DPAE KVR Shkolla Zyrat e Punës	Çdo vit	Numri i të rinjve të identifikuar Kurset profesionale të ofruara dhe të përfunduara	
Zhvillimi i praktikave profesionale pranë institucioneve të ndryshme lokale (bashkia, ZVA, qendra shëndetësore, etj)	Bashkia DPAE KVR ZVA	Çdo vit	Numri i të rinjve që përfundojnë praktikat	
“Modele suksesi që frymëzojnë të rinjtë”. Workshope me të rinj të suksesshëm të qytetit të Elbasanit që frymëzojnë bashkëmoshatarët e tyre	Bashkia DPAE KVR Shkolla	Çdo vit	Numri i workshopeve Numri i të rinjve të suksesshëm	
Trajnime për të rinjtë mbi aftësitë në tregun e punës; sipërmarrja; edukimi për karrierën	Bashkia DPAE KVR Shkolla Zyrat e Punës	Çdo vit	Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i të rinjve të trajnuar	
Kurse kodimi për të rinjtë	DPAE KVR Profesionistë të fushës	Çdo vit	Numri i të rinjve të trajnuar	
Ndërmjetësimi me bizneset dhe institucionet për punësimin e të rinjve që përfundojnë kursin e kodimit	Bashkia DPAE Zyrat e Punës	Çdo vit	Numri i të rinjve të punësuar	
SIGURIA DHE REZILIENCA E TË RINJVE KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT				
Objektivi 1: Ofrimi i programeve edukuese që zhvillojnë reziliencën e të rinjve ndaj mesazheve të ekstremizmit të dhunshëm dhe ngjallin një ndjenjë pozitive të identitetit dhe përkatësisë.				
<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financimi</i>

Veprimtari ndërgjegjësuese drejtuar të rinjve, prindërve dhe komunitetit, për t'i informuar mbi problematikat në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm	DPAE KVR Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP)	Çdo 6-mujor	Numri i aktiviteteve të zhvilluara Numri i pjesëmarrësve	
Dokumentar. Dokumentari duhet të përmbajë intervista personale të personave të përfshirë, por që janë larguar nga mjedise të ndryshme ekstremiste	DPAE KVR	Çdo vit	Dokumentari i zhvilluar	
Promovimi i të kuptuarit ndërkulturor ndërmjet individëve në moshë shkollore në zonat urbane dhe rurale përmes sesioneve informuese	DPAE KVR	Çdo vit	Numri i sesioneve informuese	
Angazhimi i të rinjve nga grupet vulnerable në sporte, kurse të ndryshme	DPAE KVR Klubi shumësportësh Qendra Kulture e Fëmijëve	Çdo vit	Numri i të rinjve nga grupet vulnerable të përfshira në sporte	
Objektivi 2: Përfshirja e të rinjve në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike Elbasan				
Krijimi i Bordit Vendor të Sigurisë Publike nga KVR	Bashkia DPAE KVR Këshilli Vendor i Sigurisë Publike	Çdo vit	Numri i të rinjve pjesëmarrës në bord	
Trajnimi i të rinjve për çështjet e sigurisë publike	Bashkia Këshilli Vendor i Sigurisë Publike Profesionistë të fushës	Çdo vit	Numri i të rinjve të trajnuar	
Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në nivel rajonal për çështjet e sigurisë publike	Bashkia Këshilli Vendor i Sigurisë Publike DPAE KVR	Çdo vit	Numri i pjesëmarrësve	